



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:283292
Datë: 27.09.2024
Numri i dokumentit: 06220164

C-IV-14-6213

Ankuesi

S Th fshati S, Lipjan.
Përfaqësuar nga Sh R S avokat, Lipjan.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 26 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN006-0030, të datës 20 gusht 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 25 shtator 2014, ankuesi përmes (përfaqësuesit të tij të autorizuar) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër vendimit nr. PRN006-0030, të datës 20 gusht 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej: Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për paga të papaguara për periudhën kohore 2007 – 2012, në shumë prej 10,800.00 € nga NSH “Shpezëtaria” (në likuidim). Përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit thekson se me vendimin nr. PRN006-0030, të datës 20 gusht 2014 kërkesa në fjalë e ankuesit nga AL është refuzuar si e pavlefshme / e parashkruar sipas dispozitës së nenit 608 të LPB (publikuar në GZ nr. 53 të vitit 1976), dispozita e të cilit ligj është i aplikueshëm në kuptim të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24, gjë që është arsyetim i pabazuar e i cili është në kundërtënie dhe konfuz me dispozitivin e këtij vendimi. Fillimisht AKP-ja gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 608 të LPB ku duke u thirrur në këtë dispozitë pretendon AKP-ja, se ankuesi ka lëshuar afatin, përkatësisht kërkesa e tij është parashkruar lidhur

me këtë fakt do të japim këtë arsyetim: Për periudhën për të cilën i referohet ankuesi kompensimit të pagave të papaguara i referohet viteve 2007 – 2012, ashtu që në këtë kohë si ligj i aplikueshëm ka qenë LMD-ja (GZ nr.29 e RSFJ-së e vitit 1978), njëherit po këto dispozita të këtij ligji rregullojnë edhe çështjen e kërkesës së kërkuarit R S dhe në asnjë mënyrë dispozitat materiale të theksuara si në vendimin e atakuar. Njëherit po ky legjislacion LMD-ja (GZ nr. 29 e RSFJ-së e vitit 1978), në kapitullin 4 kaptina 1, duke filluar nga dispozita e nenit 360 e tutje rregullon çështjen e parashkrimit të një kërkesë, e të cilat dispozita rregullojnë decidivisht, ndërsa aplikimi i dispozitave materiale nga AKP-ja në vendimin e atakuar është absolut i gabueshëm dhe jo ligjor kur i referohet parashkrimit. Ndërsa në rastin kur AKP-ja thirret në pavlefshmëri të kërkesës është absurd pasi që dispozitat e LMD-së (GZ nr. 29 e RSFJ-së e vitit 1978), duke filluar nga neni 185 e tutje rregullojnë decidivisht kërkesën e ankuesit dhe njëherit e legjitimon kërkesën e tij. Se AKP-ja ka zbatuar gabimisht dispozitat materiale vërtetohet edhe me këtë fakt në vendimin e atakuar e që padyshim se përmbajtja e saj është marr (*copy paste*) nga raste të tjera që ndërliken me NSH e që kanë të bëjnë me kërkesa të njëjta por për periudha të ndryshme kohore dhe një arsyetim i tillë i vendimit të atakuar është tepër konfuz jo profesional dhe jo ligjor. AKP-ja duke u thirrur në këtë dispozitë, arsyeton se kjo dispozitë e ligjit ka qenë i aplikueshëm edhe në rastin e kërkuarit duke u thirr në dispozitën e nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24. Po kjo rregullore (e cila legjitimon legjislacionin e ish Jugosllavisë) decidivisht parasheh të kundërtën e asaj që pretendon AKP-ja në arsyetimin e vendimit të atakuar, neni 1 pika 1.1 parasheh Ligji në fuqi në Kosovë përfshin, ndërsa pika A - parasheh Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe Instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to B - Legjislacionin në fuqi në Kosovë me 22 mars 1989. Se ky AL vërtetë ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale shprehet me këtë arsyetim, ku ende pretendon se kërkuari 3 vite pas vitit 2007 ka pasur të drejtë të kërkoj kompensim pagash, por gjendja faktike lidhur me këtë pretendim është e ndryshme, me arsyetimin e cekur më lartë. Se kërkesa e ankuesit nuk mund të kufizohet brenda një kornize ligjore dhe e njëjta ish dashtë që të zgjerohet edhe në akte dhe veprime të tjera ligjore dhe procedurale, pasi që në Republikën e Kosovës legjislacioni në fushën e punës ka pësuar ndryshime, miratime të reja të legjislacionit të punës dhe fakti se i vetmi legjislacion që ka qenë në fuqi dhe që rregullon çështjen e kërkesës së kërkuarit për kompensim rregullohet me dispozitat e LMD-së (GZ nr.29 e RSFJ-së). Nëse ju referohemi dispozitës së nenit 360 të LMD-së parasheh se parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit. Ndërsa dispozita e nenit 361 të LMD-së parasheh parashkrimi fillon të rrjedhë në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër, ndërsa dispozita e nenit 379 të LMD-së, parasheh decidivisht: Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet dhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër parashkrimi. Mirëpo, të gjitha kërkesat periodike që rezultojnë nga vendimet ose pajtimet e tilla dhe rrjedhin për pagesë në të ardhmen, parashkruhen në afatin e parashikuar për parashkrimin e kërkesave periodike. Atëherë nëse shikohet me kujdes gjendja faktike në raport me AL dhe kërkuarit mund të vërtetohet fakti se nuk kemi të bëjmë me parashkrim, pasi që AL kërkuarit ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës, ndërsa kërkesa për kompensim të pagave të papaguar është parashtrua me datë 31 mars 2014, gjë që kërkuari është brenda çdo afati pavarësisht kornizave ligjore në të cilat mund të thirret për parashkrim. Ashtu siç u theksua edhe më lartë AKP-ja të drejtën e kërkuarit nuk duhet ta shiqojë

vetëm në një kornizë të vetme ligjore siç është thirr në LPB si ligj material dhe atë të AKP-së si ligj procedural, pasi që në rastin konkret të kërkuarit e drejta për të kërkuar kompensim pagash rregullohet me dispozitat e ligjit të LMD-së, si ligj material. Ankuesi i propozon gjykatës që vendimi për të cilën kërkohet rishikimi të priset ndërsa AL i NSH-së të detyrohet që ushtruesit të kërkesës, t'ia paguaj shumën prej 10,800.00 € për pagat e papaguara për periudhën 2007-2012, duke aplikuar edhe kamatën ligjore e gjerë në pagesën definitive. Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur: vendimin e kundërshtuar dhe autorizimin për përfaqësim.

Me 10 korrik 2024, gjykata lëshoi urdhër për përfaqësuesin e ankuesit, duke kërkuar nga i njëjti që të dorëzoj prova relevante në mbështetje të ankesës. Me 23 korrik 2024, urdhri u pranua mirëpo asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Me 26 gusht 2024, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtjen e saj në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, Neni 31 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. E paditura thekson rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit pala kërkuese (parashtruesi) ka detyrimin dhe barrën e provës (Neni 7 i LPK-së dhe Neni 31 i Ligjit 06/L-086). Një rregull i tillë është shprehimisht i paraparë edhe në nenin 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. Neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parashikon “...*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij Ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë... kërkesa apo pretendimi është i parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”. Nuk ka asnjë provë përpara këtij AL që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organi kompetent. Neni 608 i Ligjit për Punën e Bashkuar (publikuar në GZ Nr.53 të vitit 1976) i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon që “*pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet. Bazuar në dispozitat e mësipërme, për të ndërprerë parashkrimin, kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre vjetëve, nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, e që është tre vjet nga viti 2007. Andaj, bazuar në më sipër, AL refuzon kërkesën si të pavlefshme. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Vendimin e kundërshtuar dhe Vendimin për emërimin / përbërjen e AL datë 4 gusht 2023.*

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Ankuesi nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit tek AL, as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL nr. PRN006-0030, datë 20 gusht 2014, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime / punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara si të papaguara, për periudhën kohore 2007 – 2012, në shumë prej 10,800.00 € nga NSH “Shpezëtaria” (*në likuidim*). Ankuesi nuk ka përcaktuar as periudhën kohore në mënyrë të saktë për të cilën kërkon pagat e papaguara dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Pra, nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimet e ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara sipas vendimit të kundërshtuar. Për më tepër, ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas urdhrin të gjykatës.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara për periudhën kohore 2007 – 2012, në shumë prej 10,800.00 € nga NSH “Shpezëtaria” (*në likuidim*), nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palëve në lidhje me objektin e kontestit, por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar